



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 118

Prishtinë, më 24.6.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Daut Haradinaj, Nijazi Idrizi.

Mungoi : Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.6.2013,
3. Shqyrtimi i aplikacioneve të pranura për Drejtor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtua për “Të ndryshme” shqyrtimi i kërkesës së banorëve të Zhupës për shfaqjen e karkalecave që dëmtojnë rëndë kulturat bujqësore si dhe gjendjen alarmuese të popullatës ku janë shfaqur ethet hemorragjike.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.6.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 17.6.2013.

3. Shqyrtimi i aplikacioneve për drejtor agjencie

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi komisionin për 8 aplikacionet e dorëzuara për Drejtor të agjencisë së komplekseve memoriale (stafi shpërndau aplikacionet), nga të cilat njëra nuk i plotëson kushtet formale si kërkohet në bazë të konkursit, ndaj ftoi komisionin të caktoi kriteret dhe të kryej obligimin ligjor duke propozuar dy kandidat për mbledhje plenare.

Daut Haradinaj potencoi faktin se kemi të bëjmë me një agjenci shumë të rëndësishme dhe me buxhet që ka të bëjë me 24 milion, për çka edhe ky komision ka vendosur të mbetet përgjegjësia e Kuvendit të Kosovës për këtë agjenci, ndaj sugjeroi që komisioni të përcaktohet për kushte pak më specifike sesa në intervistimet tjera të kandidatëve, p.sh. të bëhet testimi edhe me shkrim edhe me gojë, ai arsyetoi testin me shkrim, ngase çdo kandidat do të tregonte konkretisht si mendon të kthejë këtë gjendje me memoriale në drejtimin pozitiv.

Salih Morina nuk kundërshtoi nëse komisioni vlerëson këtë nivel të testimit, por deri tani, siç tha ai, testimi është bërë gojarisht.

Nijazi Idrizi ishte për dy format e propozuara të testimit dhe të caktohet pyetësi i përbashkët.

Liburn Aliu konstatoi se për test me shkrim nuk ka nevojë, ndërkaq pyetjet bëhen gojarisht dhe deputeti ka drejtë të parashtroi pyetje sa të dëshiron ai.

Afërdita Berisha gjithashtu u deklarua në favor të testimit gojor.

Rasim Demiri pyeti sa mundet deputeti të parashtroi pyetje profesionale dhe a do të ishte më mirë të ftohet panelisti nga profesioni i lëmisë rreth pyetjeve që duhet të parashtrohen kandidatëve, ndërsa **Liburn Aliu** u kundërpërgjigj se pyetjet bëhen në bazë të ligjit, nga të cilat më e rëndësishme do të jetë të vërtetohet a është menaxher i mirë (**Afërdita Berisha**), ndaj komisioni në vazhdim nxori :

P Ë R F U N D I M

1. **CAKTOHET** intervistimi i kandidatëve për Drejtor të Agjencisë për komplekset memoriale për ditën 2.7.2013 në orën 10,00.

2. Kandidatët do të intervistohen në formën gojore duke ftuar 7 kandidatët nga 8 sa kanë parashtruar aplikacione, për shkak se njëri kandidat nuk i plotëson kushtet formale sipas konkursit.

3. Dy kandidatët më të mirë sipas kriterit të pikave prej 1 deri 10, do të propozohen për mbledhjen plenare.

4. Të ndryshme

Në vazhdim të mbledhjes, në pikën të ndryshme Kryetari i Komisionit **Nait Hasani** me pajtimin e Komisionit vendosën dhe u kërkua si vijon :

- vizita në Kroaci do të realizohet gjatë javës nëse plotësohen disa kushte formale (vizat etj) dhe nëse arrihet kompromisi i nevojshëm ngase donatori nuk ka mundësi për financimin komplet të komisionit për vizitë,
- për shkak të gjendjes alarmuese me sëmundjen e riqrave, ditën e mërkurë më 26.6.2013 të ftohen Ministri i bujqësisë, Ministri i shëndetësisë dhe Drejtori i IKSHK për mbledhje urgjente të komisionit rreth problemit të etheve hemorragjike nga riqrrat (**Salih Morina, Nijazi Idrizi**), ndërsa **Liburn Aliu** konstatoi se me ftesë arrihet qëllimi ndoshta për vitin vijues, ngase për këtë vit asgjë nuk kanë ndërmarr institucionet. **Daut Haradinaj** tha se zakonisht te ne vajtohet pasi që të ndodhë pasoja e padëshirueshme. Në kuadër të mbledhjes ministri i bujqësisë do të informoi edhe për paraqitjen e karkalecave në masë të madhe në rajonin e Zhupës, të cilat dëmtojnë rëndë kulturat bujqësore,

- të kërkohet raporti nga AUV rreth produkteve ushqimore të “Bylmetit” si dhe të kërkohet përgjigja nga MMPH rreth kërkesës së komisionit për sqarimin e dy UA për licencat e inxhinierëve të ndërtimtarisë (**Sevdije Lama** me përkrahje edhe nga **Nijazi Idrizi**),
- të iniciohet kërkesa e prodhuesve të qumështit për zero TVSH (**Afërdita Berisha**), ndërsa Kryetari sqaroi se kjo mundësi do të vjen në shprehje pasi të ndryshohet ligji në fuqi, ndërsa **Daut Haradinaj** sugjeroi një mundësi të ngjashme sikurse me verërat- taksa të kthehet në subvencion nëse ka mundësi financiare. Lidhur me këtë çështje **Nijazi Idrizi** tha se është kërkesë e sivjetshme, ndërsa propozoi të kërkohet një raport i kontrollimit të qumështit nga AUV ngase depërtimi i një bakterjes së qumështit nuk vjen nga vendet tjera dhe është një rast i izoluar.

Mbledhja përfundoi në orën 11,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani